

2 Profesionet e infermierisë dhe kujdesit
Largimi nga profesioni si rrugëdalje

3 Intervistë me Aldo Ferrari
Largimi nga Zvicra
Çka ndodh me kursimet e mija të arkës pensionale?


4 8 Marsi i sivjetmë në Republikën e Kosovës
MARShim protestues në vend të festimit

Nr. 2 | mars 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Premite e arkave të shëndetësisë: PO Iniciativës për premite lehtësuese

Shëndeti nuk është problem luksi



Pagat ngecin, premite shëndetësore rriten për çdo vit, si për ata që fitojnë shumë ashtu edhe për ata që fitojnë fare pak.

Kështu nuk mund të vijojë më tej: Shëndeti nuk është produkt luksi, nga i cili njeriu nganjëherë edhe mund të heq dorë, por thjeshtë një parakusht për një jetë të mirë. Andaj nuk duhet të vihet në pikëpyetje, që shëndeti duhet të jetë i përballeshëm për të gjithë. Pikërisht ky është synimi i Iniciativës për premite lehtësuese.

Fletëpagesat për llogaritë e premive janë tri herë me te rënda se sa ishin para 20 vitesh. Dhe bile jo vetëm për njerëzit, që këto mund ti përballojnë fare lehtë, por për të gjithë. Premia e një përfaqësuesi ekonomik është njëte e lartë sikur e një shitëse të këpucëve, apo një punëtori të ndërtimeve. Edhe pse ka lirim të pjesshëm të premive, këtë e marrin gjithnjë e më pak amvisni dhe atë gjithmonë e në shumë më të ulëta. Pasi kantonet mjetet për këtë çështje ose i kanë ngrirë ose i kanë shkurtuar, për tu ulur tatimin për super të pasurit. Në të njëjtën kohë pagat për punëmarrësit dhe pensionet për popullatën e të mos-huarve janë rritur shumë më pak se sa premite.

Iniciativa kërkon, që asnjë amvisni në Zvicër të mos paguajë më shumë se 10% të të ardhurave për premite e arkave shëndetësore. As familjet, as prindi e personi i vetëm si dhe as pensionisti. Sot ka shumë amvisni që janë të detyruara të paguajnë

mbi 20% nga të ardhurat e tyre për premite shëndetësore. Iniciative në fjalë përfundon këtë situatë, pasi ajo do të mundësonte rritjen e liritimit të premive në mënyrë të përshtatshme. Kantonet nuk do të mundin edhe më tej të shkurtonin apo edhe përmes mundimeve e pengesave administrative të refuzonin, për lirim të pjesshëm nga premite që atyre u takojnë.

Shëndeti duhet të jetë i pagueshëm për të gjithë

Iniciativa për lehtësimin e premive ndal gjithashtu edhe zhvillimet e modelit e medicinës dy-klasash. Pasi sot shumë njerëz me të ardhura të mesme të ulëta, mendohen dy-tri herë para se të vendosin të shkojnë tek mjeku – edhe në rastet kur stomaku apo koka ka kohë që dhembë fortë. Kjo nuk është vetëm e pakëndshme, por shpesh mund të jetë edhe e rrezikshme dhe më pas edhe shumë e kushtueshme. Iniciativa kujdeset që të ulet ngarkesa e premive dhe që të të gjithë njerëzit

të mund të mbulojnë franshizat e ulëta. Kështu qasja në shërbimet elementare medicinale do të fuqizohet për të gjithë.

Në fushën e shëndetësisë mund të kursehet edhe më tej: Tek çmimet e medikamenteve, tek mbi kujdesi dhe tek rrjepja në paga. Mirëpo, sigurisht se jo që përmes pengesave financiare për të siguruarit të kufizohet rreptësisht qasja për trajtim.

Mbrojtja e të siguruarve nga shkurtimet në të ardhmen

Në vitet e fundit Kantonet janë tërhequr hap pas hapi nga lirimet e pjesshme të premive shëndetësore. Në përgjithësi marrin gjithnjë e më pak të siguruar mbështetje financiare. Përmes Iniciativës në fjalë do të duhej të përcaktoheshin rregulla më të drejta dhe solide si dhe më shumë investime për lirim individual të premive. Kjo është edhe më sociale: Pasi lirimet e premive financohen nga paratë tatimore, andaj edhe mund të zbusë karakterin

anti-social të primeve për kokë të banorit.

Me 26 shkurt 2019 iniciatorët kanë startuar zyrtarisht iniciativën për lirimet e premive. Ata duan ti japin fund marrëzisë së premive, por për të arritur këtë kanë nevojë për ndihmën e ne të gjithëve! Që nga tani keni mundësi të nënshkruani online iniciativën. Ta plotësoni, shtypni, nënshkruani dhe dërgoni pa pagesë.

Në vegën e bashkangjitur mund të gjeni Iniciativën për ta nënshkruar: bezahlbare-praemien.ch

Përmes nënshkrimit të iniciativës për lirim nga premite ne japim një sinjal të fuqishëm për një lëmin shëndetësore solidare dhe të përballeshme financiarisht!

Reto Wyss, BSZ, 26.02.2019 & ueb faqja e deputetes Barbara Gysi (adoptuar nga O. Osmanli)

Editorial



Një ditë e vitit është me rëndësi të veçantë për sindikalistët: 1 Maji, dita e lëvizjes punëtoare. Është një datë festive dhe njëherazi edhe luftarake, pasi që ne me këtë rast ne prezantojmë kërkesat tona më të rëndësishme për jetë dhe kushte me të mira jetësore dhe të punës. Këtë vit flamuri ynë i kërkesave i përkuqshohet luftës për barazi dhe jemi duke u angazhuar për një greve të fuqishme të grave me 14 qershor. Pasi ne jemi ende shumë larg nga barazia e jetuar, kjo do të jetë tema kryesore e Një Majit të sivjetmë. Mirëpo, neve na preokupojnë edhe shume beteja tjera: Lufta për të vu në binarë masat mbrojtëse, pasi pa to do të kishim dumping në paga dhe përkeqësim të kushteve të punës. Por edhe beteja për respektimin e zbatimin e ligjit të punës. Borgjezët dhe punëdhënësit duan që ne të punojmë më gjatë dhe nën kushte më të këqija pune.

Kostoja shëndetësore preokupon si sindikatat ashtu edhe një pjesë të madhe të popullatës. Sipas një ankete aktuale të Tamedia, kostoja shëndetësore u krijojnë zviceranëve më së shumti kokëçarje: Premite e arkave të sigurimeve shëndetësore rriten dhe kostoja shëndetësore ngarkon së tepërmi kuletën. Shumica e së djathtës në parlament dëshiron që të na ngarkojë edhe me më shumë harxhime: dhoma e përfaqësuesve të kantoneve ka aprovuar një propozim për ndryshim ligji, i cili parasheh që rritja e franshizës të rriten paralelisht me koston shëndetësore. Kundër këtij vendimi kryesia e Partisë Socialdemokrate ka iniciuar një referendum. Gjithashtu është iniciuar edhe një nismë për kufizimin e lartësisë së premive të sigurimeve shëndetësore, sikur është përshkruar në artikullin përkatës.

Lufta karshi sulmeve të mundshme drejtuar kundër kushteve të punës dhe jetës të punëmarrësve pra vazhdon më tej. Me 1 Maj ne prapë do të tregojmë se ne nuk dorëzohemi. Eja edhe ti për 1 Maj – sa më shumë që ne jemi aq më fuqishme është lufta jonë!

Marília Mendes

News

Të drejta të fuqishme të punëmarrësve kundër nacionalizmit dhe dumpingut në paga

Rritja e nacionalizmit, kundër strategjia e sindikatave dhe ruajtja e mbrojtjes së pagës ishin temat e sivjetme të manifestimit diskutues në Olten. Sindikatat evropiane mbështesin qëndrimin e Unia mbi marrëveshjen kornizë me BE. Shkencëtarja sociale Sophie Bose raportoi mbi hulumtimin e saj mbi tendencat e djathta nacionaliste në Gjermani. Shpesh popullariteti i argumenteve nacionaliste vjen nga një ndjenjë e pasigurisë sociale dhe mosrespektimit. Këtu duhet të vejnë theksin sindikatat. Përvojat e solidaritetit dhe angazhimi i përbashkët për kushte më të mira në vendin e punës mund të kontribuojnë që të tejkalohet përçarja tek punëmarrësit.



23 frangat minimale! Është dorëzuar iniciativa e Bazelit për pagë minimale

Si kantoni i parë i Zvicrës gjermane, ai i Qyteti Bazel do të votojë për pagën minimale. Brenda një kohë të shkurtër u grumbulluan më shumë nënshkrime se sa ishte e nevojshme. Iniciativa është dorëzuar me 21 shkurt. Iniciativa kërkon një pagë minimale prej 23 frangave në orë për të gjithë punëmarrësit në Kanton. Pos tjerash, Komiteti i udhëhequr nga sindikata Unia ka përpunuar iniciativën ligjore.

Jo 70-orë pune në javë, burnot dhe punë falas

Që nga zgjedhjet fundit parlamentare forcat e djathta janë duke punuar për një sulm total kundër punëmarrësve, shëndetit të tyre dhe kuletës së tyre. Dy iniciativa parlamentare (Keller-Suter dhe Graber) duan që rregullat kundër punës falas dhe mbrojtjes nga burnot për rreth 30% të punëmarrësve ta fshijnë nga ligji i punës, gjegjësisht të gjithë atyre që janë në «funksionet drejtuese» dhe të gjithë «specialistëve profesional» (paragrafë gome si ato të librave shkollorë). Për ta duhet hequr tërësisht rregullimi-anti-burnot i orarit të punës, kuptohet kundër dëshirës së tyre. Për ta hu do të vlen më tutje orari maksimal i punës dhe 70-rët plus në javë do të bëheshin normale. Është koha e fundit që Dhoma e përfaqësuesve të Kantoneve ti jep fund sulmeve mbi ligjin e punës.

Profesionet e infermierisë (kujdesit) Përkujdesja rrezikon shëndetin

Kujdesi afatgjatë stacionar po ndryshon e transformohet, në dëm të kujdestarëve. Stresi, mungesë personeli, ankesa shëndetësore, janë vetëm disa nga pikat. Shumë kujdestarë (infermier/e) distancohen nga profesioni i tyre dhe duan ta lënë atë. Zgjidhje ka – dhe ato janë të nevojshme që tani.

Largimi nga profesioni si rrugëdalje
Një anketë e Unia tregon: 47% e të punësuarve në kujdesin afatgjatë nuk qëndrojnë në profesion deri në pensionim. Ndër profesionistët e punësuar në shëndetësi përqindja arrin në 52. Të largohen nga profesioni duan para së gjithash ata që janë deri në moshën 30 vjeç. Këto janë perspektiva tragjike, pikërisht për një sektor, në të cilin mungon personeli.

Kujdestarët kontribuojnë shumë dhe paguhet pak për punën e tyre. Në shumicën e kantoneve ndihmës-kujdestarët/et fitojnë mes 3800 dhe 400 frangave bruto. Punësimi i përgjithshëm në kujdestari është mesatarisht 72% (jo punësim 100%). Kjo domethënë, kujdestarët duhet të mjaftohen me 2700 franga në muaj. Një punë të dytë nuk lejojnë shumë nga ndërmarrrjet, për të mundur që sipas nevojës ti planifikojnë dhe ti kenë në dispozicion të punësuarit në çdo kohë. Dhe për të punuar 100% nuk parapëlqejnë fare shumicë e kujdestarëve.

Punë jo e shëndetshme

Ngarkesat shëndetësore janë një nga arsyet kryesore, që shumë kujdestarë duan ta lënë profesionin e tyre. Të anketuarit kanë thënë se: 70% e tyre i janë nënshtruar stresit gjatë punës; 86% ndihen të lodhur dhe të djegur; 72% kanë ankesa trupore.

Punëdhënësit dhe shoqatat e tyre «cufravi-va» dhe «sensesuisse» duhet të zhvillojnë

një vetëdije për problemet e kujdestarëve dhe të mundësojnë dhe ti hyjnë një dialogu të partneritetit social në nivel të shtëpive të pleqve dhe në tërë sektorit. Ajo çka u nevojitet punëdhënësve janë: plane korrekte pune, jo orar vjetor pune, paga, të cilat duhet të mjaftojnë për jetesë dhe më shumë personel.

Unia kërkon pos tjerash një rregullim të ri të financimit të kujdestarisë. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një diskutimi të gjerë politik dhe shoqëror. E qartë është se: Kompensimet për kontributet e kujdestarisë duhet të rriten.

Osman Osmani



Personeli i kujdesit punon nën kushte të përkeqësuar pune dhe jetese

Përgjithësisht bilanc pozitiv pas një viti KKP Më shumë kontrole në sallonet e flokëve në të ardhmen

Partnerët social bëjnë një bilanc pozitiv një vit pas hyrjes në fuqi të KKP për degën e (salloneve të) floktarëve zviceranë. Pagat minimale dhe nxitja e trajnimeve kujdesen për një vlerësim të degës dhe për përmirësim të perspektivës për të ardhmen e personelit. Duke pasur parasysh zgjerimin e dumpingut në paga partnerët social kanë vendosur, që në vitin 2019 të bëjnë më shumë kontrole të paparalajmëruara në sallonet e flokëve për respektimin e KKP-së.

Ndikimet e Kontratës Kolektive të Punës (KKP) të hyrë në fuqi para një viti për degën e salloneve të flokëve (frizerëve) kanë rezultuar pozitivisht si për personelen ashtu edhe për punëdhënësit. KKP e deklaruar obliguese nga ana e qeverisë federale zvicerane vlen për 4200 sallone flokësh dhe 10700 të punësuar, nga të cilët 95% janë

gra. Për të siguruar konkurrencën që nuk ndikon në kurriz të kushteve të punës, janë futur pagat minimale posaçërisht për të punëmarrësit e arsimuar dhe të punësuarit pa arsimim të njohur. Përmes KKP-së janë nxitur edhe ofertat për organizimin e trajnimeve të mëtejme nga ana e partnerëve kontraktues.

250 kontrole të paparalajmëruara në vitin 2019

Partnerët social janë të organizuar në komisionet e paritetit, të cilët janë të ngarkuar me kontrollin e zbatimit të KKP-së. Në vitin 2018 janë zhvilluar 200 kontrole. Në 55% e ndërmarrjeve janë gjetur shkelje kundër rregullave të pagës. Duke pasur parasysh numrin e madh të përsëritjeve të shkeljeve karshi KKP-së dhe të shumë akterëve të ri në treg, të cilët shtypin çmimet, partnerët social kanë vendosur që veprimtarinë tyre kontrolluese për vitin 2019 ta shtojnë. Krahas 200 kontrolleve të rregullta, duhet të zhvillohen edhe 250 kontrole tjera shtesë. Një fazë testuese nga viti i kaluar ka treguar se kontrollet e paparalajmëruara janë të nevojshme dhe kanë ndikim edhe parandalues. Për të perceptuar këto detyra shtesë, në 20 Kantone është vu në binarë një bashkëpunim me organet kontrolluese. Me këto masa të fuqishme partnerët social do të kujdesen për një konkurrencë të shëndoshë dhe kështu edhe të stabilizojnë kushtet për ushtrimin e profesionit në fjalë.

Marrë nga kumtesa për media e sindikatës Unia e Syna si dhe shoqatës së salloneve zvicerane të floktarisë



Sallonet e floktarisë përmes kontrolleve deri tek konkurrenca korrekte

Qëllimet vjetore të GI për Migracion Sfida të mëdha janë para nesh

Unia këtë vit gjendet par sfidave të mëdha, andaj edhe qëllimet e gjithë organizatës janë të orientuara drejt sfidave qendrore.

14 qershori: greva e grave

Deri më 14 qershor – dita e grevës së grave – të gjitha energjitë tona do të drejtojmë për mobilizim të fuqishëm në degët e sektorët si dhe përtej tyre. Ajo çka ne do të na sfidojë pas grevës së grave, janë sulmet karshi masave mbrojtëse (FlaM) dhe shtypja e pagave. Për këtë Unia në pjesën e dytë të vitit do të nisë një fushatë pagash dhe do të mbrojmë me tej masat mbrojtëse (FlaM). Në grupin e interesit të migracionit ne do të përqendrohemi në dy tema kryesore.

Njohja e diplomave të huaja

Çështja e diplomave të huaja prek shumë anëtare tanë. Andaj ne sivjet do të përpunojmë bazamentin e materialit informues për këtë temë. Qëllimi është që në njërin anë të informojmë anëtarët tanë për procedurat e njohjes së diplomave. Ndërsa në anën tjetër ne duam që çështjen e njohjes së diplomave të huaja ta bëjmë temë tek Kontratit Kolektive të Punës. Bashkë me Bashkimin e Sindikatave të Zvicrës ne jemi duke përpunuar një studim mbi këtë temë. Ky studim duhet të shërbejë për të ndikuar politikën dhe për arritur përmirësime sa i përket njohjes së diplomave të huaja.

Informim dhe arsimim mbi ligjin e ri për të huajt

Me ligjin e ri për integrim dhe të huajt do të ketë përshtatje të statutit të qëndrimit. Qysh sot mund të vijmë në përfundim se ka pasiguri sa i i përkeqësimi të qëndrimit. Praktikant tregojnë se Kantonet të caktuara qysh tani zbatojnë ligjet në jo favorshëm për migrantët. Ne kemi vu si qëllim të informojmë anëtarët tanë mbi situatën aktuale dhe për të organizuar manifestime arsimore për personat e besuar dhe seminare për anëtarët aktivë mbi këtë temë.

Zoltan Doka



Delegatët e komisionit të migracionit solidarizohen me ditën e grevës së grave

Greva e grave 2019: Përse?

Arsyet për grevën e grave janë të mjaftueshme. Paga t dhe pensione të ulëta, të cilat nuk mjaftojnë për të jetuar, mungesë respekti dhe vlerësimi i mangët për punën tonë (me e pa pagesë) janë maja e ajsbergut.

Paragjykimet, seksizmi dhe diskriminimi godasin gratë në të gjitha rrafshet e jetës dhe kufizojnë ato në të drejtat edhe liritë e tyre. Që pos kësaj të jenë të konfrontuara edhe me ksenofobi e racizëm, dyfish të diskriminuara janë migrantët. Shanset e njëjta dhe barazia ende janë shumë larg për tu arritur.

Edhe pse ne profesionet dhe punët tona i ushtrojmë me pasion dhe me zemër, ato nuk vlerësohen thuaja se fare. Ne duhet të kontribuojmë gjithmonë dhe edhe më shumë. Me më pak personel, për po atë paga dhe në kohë edhe më të shkurtër. Kështu duan punëdhënësit dhe të djathtët. Stresi dhe ngarkesat në vendin e punës sa vijnë e rriten, ndërsa sfidë edhe më e vështirë mbetet harmonizimi i familjes dhe profesionit. Për arsimim e trajnim të mëtejshëm nuk mbeten as para e as kohë. Edhe jeta në moshë të shtyrë, për shkak të pagave e pensione të ulëta, për shumë nga ne më shumë është luftë për të mbijetuar se sa pensionim me dinjitet.

Andaj ne kërkojmë: Respekt! Më shumë pagë! Më shumë kohë! Respekt për ne dhe punën që bëjmë, pavarësisht nga prejardhja dhe gjinia jonë. Më shumë pagë për punën tonë, pasi ne duam të jetojmë nga pagat dhe pensionet tona. Më shumë kohë për ne, për familjet tona, për jetën tonë.

Të gjitha këto të vijnë si të njohura? Na trego historinë tënde dhe bëhu pjesë e grevës së grave. Të gjitha informatat i gjen në: www.frau-streikt.ch.

Manuela Giovanoli, sekretare për politikë të barzisë gjinore



Pamje nga aksioni i 8 marsit në Bernë për barazi në pagë

Intervistë me Aldo Ferrari Largimi nga Zvicra: Çka ndodh me kursimet e mija në arkën e pensioneve?



Gjithmonë migrantët shtrajnë pyetjen rreth pensioneve të pleqërisë, në rastin kur duan të largohen nga Zvicra. Aldo Ferrari, nënkryetar i sindikatës Unia dhe specialist i sigurimit profesional, ka dhënë përgjigje në pyetjet e gazetës Horizonte.

Shumë migrantë/ë kanë drojë, që në të ardhmen nuk do mund të nxjerrin kursimet nga arka e pensionit, në rast se vendosin që të lëshojnë Zvicrën. A qëndron kjo?

Jo kjo nuk qëndron kështu. Në kuadër të shqyrtimit të revidimit të ligjit mbi përfitimet shtesë, çka është e vërteta është diskutuar edhe përfundimi i pagesës së kursimeve nga arka e pensioneve. Kjo arsyetohej me faktin se shumë njerëz i harxhojnë parat e tyre të arkës së pensionit dhe më vonë janë të detyruar të kërkojnë përfitime suplementare. Mirëpo ky propozim nuk kishte shans dhe u tërhoq tërësisht nga projekt ligji. Edhe më tej është mundur tërheqja e parave nga arka e pensioneve. Kushdo që e lëshon Zvicrën, pra mundet me plotësimin e kushteve të caktuara të merr me veti paratë e arkës së pensioneve.

Cilat janë këto kushte?

Së pari duhet dalluar se a është largimi në një vend të BE-së apo jo. Në një vend jo të BE-së secili ka të drejtë të nxjerr kapitalin nga arka e pensioneve, nëse këtë e lejon rregullorja e arkës gjegjëse të pensionit. Arkat e paritetit të ndërtimit dhe artizanaleve, p.sh. e lejojnë një gjë të tillë. Është e mundur tërheqja vetëm nëse këtë e lejon rregullorja e akres pensionale. Mirëpo, edhe në rast të tillë, shuma e tërhequr duhet të jetë së paku 25% e kapitalit të kursyer.

E në rastin kur dikush vendoset në një vend të BE-së?

Pjesa e kapitalit që është mbi atë obligues të arkës së pensionit, secili/a gjithmonë mund ta merr me veti. Në dëftesën e arkës së pensionit është e shënuar, se sa ka kursyer pësoni gjatë jetës së punës (d.m.th. Tërheqja e përfitimi apo kapitali në moshën e daljes në pension). Aty është e deklaruar edhe shuma bazuar në sigurimin e përkujdesjes profesionale. Dallimi mes këtyre dy shumave është kapitali i grumbulluar kursyes mbi obligues, të cilin personi gjithmonë mund ta merr me veti me rastin e vendosjes në një vend të BE-së.

A vetëm kjo pjesë e kursimit mbi obligues mundet të merret me veti në një vend të BE-së?

Jo. Nëse punëmarrësi me rastin e largimit nga Zvicra është në moshën e pensionimit ose, nëse këtë e lejon rregullorja e arkës së pensioneve, keni arritur moshën për pensionim të parakohshëm, atëherë mundeni të kërkonit pagesën e gjithë kapitalit tuaj të arkës së pensioneve. Para pensionimit kjo është e mundur vetëm në rast se ne vendin tjetër nuk i nënshtrohemi sigurimeve shoqërore (d.m.th. nëse nuk punoni dhe nëse nuk merrni pension nga sigurimet shoqërore). Kjo kontrollohet nga enti ndërlidhës e fondit të sigurimit profesional në vendin e ri. Pos tjerash kursimi mund të tërhiqet edhe për pavarësi profesionale (në vitin e parë në botën e jashtme, për një shoqëri personash dhe vetëm në rast se në vendin e ri nuk i nënshtrohet sigurimit profesional), ose për blerje, ndërtim apo renovim të pronës personale banesore të vetë përdorur, si dhe mund të përdoret edhe për amortizim të një hipoteke.

A ka shqyrtimi i ligjit për përfitimet shtesë ndikim në paratë tona të arkës së pensioneve?

Po. Asgjë nuk është vendosur përfundimisht, mirëpo një risi e kënaqshme është se, kushdo që në moshën 58 vjeç mbetet i papunë, mund të mbetet edhe më tej në arkën e pensioneve dhe më vonë të përfitojë nga pensioni. Aktualisht kjo ende nuk vlen: Kush tani para pensionit mbetet i papunë, humb të drejtën për të qenë edhe më tej pjesë e sigurimit profesional. Paratë paguhen në një llogari bankare vetjake përfitimi dhe kushtet me rastin e pensionimit janë shumë më të këqija. Mirëpo ne do të informojmë me kohë në rast të aprovimit të ligjit (në parim në sesionin parlamentar pranveror).

Nëse dikush me rastin e pensionimit vendoset në një vend të BE-së, a do të mund të vendoste për një pension nga arka e pensioneve?

Po, kjo është e mundur. Me këtë rast personi i siguruar do të duhej të peshonte mirë se çka flet për e çka kundër dhe të shikohet me kujdes rregullorja e arkës së pensioneve. Duhet pasur parasysh se p.sh. tërheqja e kursimeve nga arka e pensioneve nënkupton heqja dorë nga pensioni për trashëgimtarë, për bashkëshortë dhe fëmijë të cilët ndjekin arsimimin deri në moshën 25 vjeç, nëse arka e parasheh këtë. Është më rëndësi që anëtarët të keshillohen tek sindikata. Kështu ata do të merrnin informim dhe këshillim aktual, pasi në këtë fushë janë duke ndodhur shumë ndryshime.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Pensionimi: A nuk marr kompensim të mëdijtjes më tej?

Unë kam pësuar aksident në janar të vitit 2018. Andaj unë nga sigurimi aksidental kam marrë mëdijtjen. Në nëntorin e fundit, sigurimi aksidental më ka komunikuar, që nuk do të mi paguaj më tej mëdijtjen, pasi unë do të pensionohesha në dhjetor. A është kjo procedurë e saktë?



Aksidenti: Përderisa nuk jeni shëruar plotësisht, edhe pas pensionimit merrni mëdijtjen e kompensuar. (Foto: iStock)

Myriam Muff: Jo. As arritja e moshës së pensionimit e as data e daljes në pension nuk duhet të shërbejë si shkas për të ndaluar mëdijtjen e aksidentit. E drejta juaj për mëdijtje vazhdon të vlejë edhe më tej, përderisa nuk keni arritur përsëri aftësinë e plotë për punë, apo përderisa nuk ka përfunduar shërimi. Vetëm pasi të ketë përfunduar shërimi dhe të është arritur i ashtuquajtura gjendje përfundimtare shëndetësore, atëherë sigurimi mund të ndalë pagesën e mëdijtjeve. Më pas, sigurimi i aksidenteve duhet të shqyrtojë drejtë e mundshme për pension. Andaj ju këshillojë që ti drejtoheni me një shkresë rekomandime sigurimit aksidental dhe ti kërkonit pagesën e mëtejme të mëdijtjeve. Mund të ndodh që sigurimi aksidental të ngul këmbë edhe më tej në ndalesën e mëdijtjeve. Në rast të tillë duhet të veproni menjëherë, pasi afati i ankesës është 30 ditë. Si anëtarë i Unia mund të drejtoheni tek këshillimorja e seksionit tuaj të Unia-s.

Work, 1.2.2019

Dhimbje kronike kurrizi: A duhet të lajmërohem tek sigurimi i invaliditetit (IV/AI)?

Ka mbi një gjysmë viti që me vërtetim mjekësor jam i sëmurë shkaku i lëngimit nga kurrizi. Në ndërkohë shefi im më ka pushua nga puna, ndërsa sigurimi i mëdijtje të punës në rast sëmundjeje më ka shkruar se unë duhet të lajmërohem në IV/AI (sigurimi i invaliditetit). Mjerisht unë nuk kam shumë shpresë se kurrizi im do të bëjë më mirë. A duhet unë tani të lajmërohem tek sigurimi i invaliditetit (IV/AI)?

David Aebly: Po. Sigurimi i mëdijtjeve në rast sëmundjeje paguan maksimalisht 720 mëdijtje, pra përgjatë dy viteve. Shpesh përfitimet përfundojnë më herët, nëse udhëzoheni për tek mjeku i besueshëm i sigurimit dhe i cili është i mendimit se ju edhe përkundër lëngimit mund të punoni në ndonjë profesion tjetër. Sigurimi i mëdijtjeve në rast sëmundjeje juridikisht nuk mund të ju detyrojë të lajmëroheni tek sigurimi i invaliditetit (IV/AI), mirëpo nëse ata dhe mjekët janë të njëjtit mendim, se ju edhe pas përfundimit të dy vjetëve ende nuk do të jeni përsëri plotësisht i aftë për punë, atëherë lajmërimi tek sigurimi i invaliditetit (IV/AI) është i nevojshëm. Pasi IV/AI paguan tek gjatë muaj pas lajmërimit. Përndryshe papritur mbeten pa punë dhe pa pagë dhe nuk keni mundësi as të lajmëroheni tek arka e papunësisë, pasi nuk plotësoni kushtet për ndërmjetësim pune. Sigurimi i invaliditetit, nëse edhe mjekët vijnë në përfundim se jeni i paaftë për punë, do tu mundësojë një ri arsimim e riaftësim apo varësisht nga shkalla e sëmundjes edhe tu paguaj një pension invaliditeti. Nëse IV/AI ju paguan pension, keni të drejtë në përfitim të pensionit të invaliditetit edhe nga arka e juaj e pensionit. Dhe nëse këto nuk mjaftojnë për jetesë, atëherë mund të kërkonit përfitim suplementar.

Work, 15.2.2019

Zgjedhjet në BE Përbërja e Parlamentit Evropian

Zgjedhjet për Parlamentin Evropian mbahen nga 23 – 26 maj 2019. Shtetari/et e BE-së kanë rastin dhe mundësin, të zgjedhin forcat, të cilat angazhohen për një Evropë më sociale, për të drejta të punëmarrësve dhe për më shumë demokraci. Në vijim mund të gjeni disa informata të dobishme.

Çka është Parlamenti i BE-së?

Parlamenti i BE-së në gjithë botën është i vetmi parlament trans-nacional dhe përfaqëson interesat e 500 000 000 shtetasve/eve të BE-së. Është institucioni i vetëm në BE-së, anëtarët e të cilit zgjidhen drejtpërsëdrejti nga populli. Parlamenti ka funksione të rëndësishme. Ai zgjedh kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Evropian, vendos për ligjet dhe buxhetin e BE-së. Sa më shumë

forca sociale të jenë të përfaqësuara në Parlament, po aq është orientimi social i BE-së. Kjo ka ndikim në jetën e të gjithë shtetasve/eve, mirëpo edhe fjala bie të zvicëranëve/eve (shih Nr. 1/2019 të Horizonte).

Si është përbërja e Parlamentit të BE-së?

Deputetët e BE-së organizohen në fraksionet (grupet parlamentare) politike

me programe dhe identitete të përafërta politike. Secili grup parlamentar duhet të ketë së paku 25 deputetë dhe duhet të përfaqësoi ¼ e shteteve anëtare. Partitë nacionale sipas rregullit i bashkëngjiten grupit gjegjës parlamentar dhe shpesh zhvillojnë fushata të përbashkëta politike. Aktualisht në Parlamentin e BE-së janë 8 (grupe parlamentare) fraksione. (shih edhe grafikën e bashkëngjitur)



Mposhtja e politikës së ankthit nacionalist

Gati dy milionë njerëz në Zvicër posedojnë një pasaportë të BE-së, dhe nëse kanë drejtë vote në vendin e tyre – gëzojnë edhe të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhjet e BE-së. Ne u rekomandojmë atyre që në këto zgjedhje me votën e tyre të fuqizojnë forcat sociale dhe demokratike. Parlamenti i ri i BE-së do të duhet të pësonte një kthesë dhe të bëhej më social. Për tu arritur kjo, duhet mposhtur forcat radikale nacionaliste, të cilat politikën e tyre e bazojnë në ankth.

Marilla Mendes

Partia Popullore Evropiane – p. sh. CDU-ja gjermane, Forza Italia e Berlusconi, PSD and PP portugeze, Fidesz hungareze e Viktor Orban.

Aleanca Progresive e Socialdemokratëve – p. sh. SPD-ja gjermane, PSOE spanjoll, Parti Socialiste franceze.

Konservatorët dhe Reformatorët Evropian – p. sh. PIS-i polak, Partia Popullore Daneze Aleanca e Demokratëve dhe Liberalëve për Evropë – p. sh. La République en Marche de Emmanuele Macron franceze, FDP-ja gjermane

E Majta e Bashkuar Evropiane / E Majta e Gjelbër Nordike – p. sh. CDU-ja portugeze dhe Bloco de Esquerda, Die Linke gjermane, Syriza greke.

E Majta e Bashkuar Evropiane / E Majta e Gjelbër Nordike) – p. sh. të Gjelbërit gjerman, austriak dhe belg.

Evropa e Lirisë dhe Demokracisë së drejtpërdrejtë – p. sh. UKIP-i britanik, 5 Stelle italiane, AfD-ja gjermane.

Evropa e Kombeve dhe e Lirisë) – p. sh. Front Nationale franceze, Freiheitliche Partei austriake, Lega Nord italiane.

8 Marsi i sivjetmë në Republikën e Kosovës MARShim protestues në vend të festimit

Më 8 Mars 2019, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, në Prishtinë kryesisht gra por edhe burra solidarizues protestuan dhe nuk u festuan, sepse as ne në fakt si shoqëri nuk kemi arritur drejtësi gjinore dhe shoqërore. Prandaj, nuk ka arsye të festohet. Protestuesit kundërshtojnë dhe luftojnë papunësinë dhe varfërinë, e cila është formë e dhunës strukturore që ushtrohet ndaj qytetarëve dhe qytetarëve të Republikës

Marshimi i sotëm i disa qindra protestuesve e protestuesve filloi aty kah ora 12:00 tek sheshi Zahir Pajaziti, duke parakaluar rrugëve kryesore të kryeqytetit për t'i treguar edhe njëherë

komuniteteve tona lokale dhe globale se ne do të angazhohemi pavarësisht sfidave për një shoqëri diverse dhe të barabartë.

Diversiteti i pjesëmarrësve në protestë

Kësaj proteste iu ishin bashkëngjitur edhe komunitete tjera të stigmatizuara e të diskriminuara, të cilat me pankartat shumëngjyrëshe dhe shumë domethënëse në gjuhën e tyre adresonin shqetësimet dhe kërkesat e tyre të drejta.

Organizatorët/ët në ftesën e tyre për protestë ndër të tjera theksojnë se: **MARSHI** nuk përfundon këtu. Ne do të vazhdojmë, me **PROTESTË** dhe **REZISTENCË** politike ndaj padrejtësive patriarkale dhe shoqërore.

Për gatë dhe të gjithë që ndihen të shtypur nga stereotipet gjinore, ne do të dalim të **MARShojmë**. Do të **MARShojmë** për të gjitha punët e shumëfishta që gratë bëjnë të paguara dhe të pa paguara.

Osman Osmani



Pamje nga marshimi i sivjetmë me rastin e 8 Marsit në Prishtinë